

TË "VALLËZOSH" ME VDEKJEN

Mendim SFIDA

Ky dimër i sivjetshëm më duket se erdhi si një ushtri pushtuese, që e njeh shumë mirë artin e luftës pushtuese. Ai për më se një muaj "sulmoi" me të ftohtin brisk, çka po paralajmëronte se fill pas kësaj faze edhe mund të "sulmonte" me tërë "arsenalin" e vet pushtues, për të bllokuar çdo arterie, çdo mundësi, çdo komunikim me jetën, çka edhe e bëri ashtu. Dua që nëpërmjet këtyre radhëve të këtij shkrimi të ndalem në disa këndvështrime për situata të tilla, por edhe më të vështira, të shkaktuara nga natyra, e që i ka hequr në kurriz shqiptari. Dua të filloj me tërmetet, si forca madhore, që s'përfillin asnjë vullnet a dëshirë njerëzore. Nuk dua të shtrihem në histori, por do të ndalem në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë e këndeje, deri më sot. "Ndoshta" natyra nuk i godet vendet a popujt për nga ngjyra e tyre, sidomos politike. Ajo nuk është aq e marrë sa të kopjojë njeriun! Në gjysmën e dytë të shek. të kaluar, Shqipëria kishte një regjim shtetëror që drejtohej nga Pushteti Popullor, e që frymëzohej nga Partia e Punës së Shqipërisë, parti kjo e themeluar, e drejtuar dhe e udhëhequr me një largpamësi vizionare, të paparë e të papërsëritshme, të pashoqe për nga vlerat, për atdheun e kombin tonë, nga ENVER HOXHA.

Që nga viti 1959 e deri në vitin 1990 Shqipëria është goditur nga shtatë tërmete që i kanë shkaktuar vendit, popullit e ekonomisë së Shqipërisë shumë pasoja, që për vende të vogla, siç ishte e është Shqipëria, do të ishin katastrofike, rrënuese e të papërbalueshme. Tërmeti 9-balësh i vitit 1959, me epiqendër Lushnjën, që preku edhe Fierin, Rrogzhihën, Peqinin, e Beratin; tërmeti i vitit 1960 me epiqendër në Korçë, që shkatërroi 1479 ndërtesa; tërmeti i vitit 1967 që goditi Dibrën e Librazhdin, e që shkatërroi 177 fshatra, ku shkaktoi edhe 12 të vdekur e 174 të plagosur; tërmeti i vitit 1979 që shkatërroi pothuajse Shkodrën e Lezhën, e që shkaktoi këto pasoja: Dëmtoi 17118 shtëpi e objekte social-kulturore; tërmeti i vitit 1982, me epiqendër në Roskovec (Fier), që shkatërroi 16534 ndërtesa e vrau një person e plagosi 12 të tjerë; tërmeti i vitit 1988, që goditi Tiranën e dëmtoi 2083 shtëpi dhe, i fundit, në atë gjysmë shekulli, ai i vitit 1990, që goditi Fushë-Bardhën (Gjirokastrë).

Por, Shqipëria e asaj periudhe u përball edhe me dy dimra të mëdhenj që ende mbahen mend, si ai i vitit 1953, e ai i vitit 1985. Shqipëria zyrtare e kësaj periudhe provoi edhe krizën e thellë të njohur me emërtimin, "Koha e racionit", aty nga vitet 1947, 1948, por edhe situatën tepër të rëndë të shkaktuar nga tradhtia në kreun e Kampit Socialist e BRSS, ku Shqipëria në vitin 1960, e lënë pa mbështetje dhe e futur në darën e egër të bllokadës së gjithanshme ndërkombëtare, për shkak të qëndrimit të vet parimor, atdhetar e burrëror, s'kishte më, vetëm për pesëmbëdhjetë ditë

bukë; provoi edhe presionet, sulmet e shantazhet e panumërta që organizoheshin kundër Pushtetit të popullit, nga ish-klasat e përmbysura nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit fitimtar, klasa ato që ishin në koalicion me ata që sot na hiqen si "aleatet" tanë më të sigurt e, që në të vërtetë e copëtuan Shqipërinë, në vitin 1913 pa pikë mëshirë, duke ua dhënë fqinjëve tanë shovinistë pjesët më të mira të saj, sikur ajo të kishte qenë e keqja më e madhe nga e cila kishte vuajtur Evropa plakë(!) Dua të ndalem në një fakt që në këto kohërat e pas nëntëdhjetës lakohet e stërlakohet, nga "politikantët" e kohës demokratikase, si zbulimi i tyre më i madh, në termin "Diktaturë" e, "diktator".

Vërtet shteti shqiptar i viteve 1945 - 1990 quhej shteti i "Diktaturës së Proletariatit", shtet që shprehte e mbronte në mënyrën më të përkryer interesat e shumicës së popullit, interesat e bashkëkombësve te vet në trojet e tyre natyrore, por edhe të atyre që ndodheshin në diasporë. Argumentet janë të panumërt e, s'dua të ndalëm në këtë aspekt. Kur duan që ta godasin sistemin e vlerave njerëzore, Socializmin, pseudopolitikanët tanë i drejtojnë e i zbrazin të gjitha bateritë e sulmit të tyre bizantin, kundër figurës historike më të madhe e me te lavdishme të Kombit tonë, ENVER HOXHËS. Kjo e ka shpjegimin e vet, sepse **Ai me Partinë që themeloi, udhëhoqi e, me Pushtetin që ia dha popullit, e bëri Shqipërinë ZONJË, ashtu siç e kishin ëndërruar edhe rilindësit tanë, e bëri shtetin shqiptar të pavarur nga askush, me dinjitet e krenar për politikën që ndiqte si ndaj popullit të vet, ashtu edhe në marrëdhëniet e shumta me popujt e shtetet e tjerë miq e jomiq.**

Tek e shikoj Shqipërinë e këtyre viteve demokratikase, e në veçanti të këtyre ditëve të kolapsit total nga dimri natyror, i ndihmuar edhe nga "dimri" politik, s'mundem të mos bëj analiza e gjykimë, qoftë edhe me vetveten, pasi një gjë të tillë po e bëjnë prej shumë vitesh e, më shumë këto ditë, njerëzit e thjeshtë, populli fukara, ku edhe bardhësia e borës u nxi nga dhembja e pesha e mjerimit që s'ndon në pjesën dërrmuese të popullsisë, në shtetin e "demokracisë" borgjeze shqiptare(!)

Dimrat natyrorë janë dukuri të njohura nga populli ynë, për shkak të pozitës gjeografike që zë truallin ynë, por lënien e tij në mëshirë të fatit në situata që paralajmërojnë "arreste" kardiake për një popull, nga sistemi që erdhi në pushtet, me 1990, këtë akoma s'po e pranon e s'po e "kupton" ky popull.(!)

Ky popull, me zë e nën zë i drejtohet shtetit të sotëm kapitalist, si dikur atij që e kishte të vetin, duke e ditur se shteti e pushteti i borgjezisë, vetëm fjalët në raste fushatash elektorale i ka me "fytyrë" njerëzore, ndërsa zemrën, gjatë tërë kohës e ka si të ujku. I përmenda tërmetet që kanë goditur Shqipërinë, në kohën e SOCIALIZMIT, por edhe vështirësitë e tjera jo pa një qellim. Shqipëria e asaj kohe, vërtet kishte në krye të shtetit e të Partisë së vet

një "diktator" me kuptimin e drejtë të kësaj fjale. Keni durim e më lexoni më poshtë:

Enver Hoxha ishte diktatori më i pamëshirshëm i pushtimit nazi-fashist të vendit, prandaj iu vu "me bukë në trastë" për ta luftuar e shpartalluar atë, në krye të popullit liridashës e kryengritës, për çlirim kombëtar e shoqëror. Falë këtij shpirti prej "diktatori" kundër pushtimit, prapambetjes së gjithanshme, mjerimit, vuajtjeve, injorancës, analfabetizmit, patriarkalizmit, besëtytnive të kota fetare, dhunimit e skllavërimit te femrës shqiptare, sëmundjeve shfarosëse, vëllavrasjeve, gjakmarrjes, përçarjes fisnore, krahinore a kombëtare, errësirës intelektuale e shpirtërore, Shqipërisë iu ripërtëri fytyra, e popullit iu mbush zemra plot me ndjenja njerëzore. Falë edhe këtij shpirti prej "diktatori" të këtij njeriu, kundër këtyre të këqijave kombëtare, populli ynë doli në dritën e vërtetë të Lirisë së vërtetë; doli në rrugën e ecjes vetëm përpara, drejt rritjes e përparimit të gjithanshëm ekonomik, shoqëror e njerëzor. Fatkeqësitë natyrore që e kanë goditur Shqipërinë Socialiste, ndonëse ishin tepër të rënda, pasojat e tyre eliminoheshin në një kohë rekorde, falë organizimit të përsosur të shoqërisë, falë mobilizimit të popullit, që bënte shteti, të rinisë, të ushtrisë e resurseve të tjera, në shërbim të interesave të popullit, Kombit e Atdheut, nën parullën kuptimplotë: **"Një për të gjithë e, të gjithë për një!"** Dua të përmend faktin kur pasojat e tërmetit të vitit 1967, në Dibër e Librazhd, ndonëse në kulmin e dimrit, mijëra shtëpi e objekte social-kulturore u rrafshuan e u dëmtuan, por brenda një kohe rekord, dy muajshe, pasojat e rënda u eliminuan tërësisht. Edhe kur tërmeti i vitit 1979, që goditi rëndë rrethet Shkodër e Lezhë, falë shpirtit "diktatorial" të Enver Hoxhës, edhe kundër fatkeqësive të natyrës, pasojat e atij tërmeti të lahtarshëm u likuiduan brenda pesë muajve. Ky rast e habiti edhe OKB-në, aq sa ajo dërgoi në këto dy rrethe specialistët e vëzhguesit e saj për të verifikuar e vërtetuar deklarimin nga shteti ynë në eliminimin e atyre pasojave. Këta specialistë e vëzhgues, provuan me mjetet e tyre në shumë fshatra e në dy qytetet, në se shtëpitë e objektet e ngritura ishin të vërtetë apo false, por kur panë se të gjitha ishin ndërnuar që nga themelet e ishin riparuar me gurë, tulla, hekur e beton e, ishin bërë sisteme fshatash, me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, ata ngelën të habitur, edhe për shpejtësinë, edhe për cilësinë. **Ja, pra, çdo të thotë të jesh "diktator" kundër së keqes kombëtare!** I tillë ishte Enver Hoxha ynë i pavdekshëm. Në dimrin e vitit 1985, kur Shqipëria nuk kishte "aleatët" e fuqishëm që ka sot e, as ishte anëtarë e NATO-s, dimër i ngjashëm me këtë të këtyre ditëve, rrugët i hapi populli, pushteti i popullit në bazë e, ushtria popullore skaj më skaj të vendit të bllokuar nga bora.

Në qytetin malor të Bajram Currit, në atë vit kishte rënë më se 1.5 m.

borë, por rrugët nëpër qytet u hapën brenda tri-katër orëve, duke vënë në shërbim të këtij qëllimi edhe tanket e ushtrisë, të cilat pas nëntëdhjetës i shiten për skrap, me kile, (!) u shpërndanë të gjitha drutë e zjarrit, falas për çdo familje në qytet e në lagjen e shpëputur të Cerrnicës, nga magazinat e tregtisë në qytet, u furnizuan dyqanet me të gjithë artikujt e domosdoshëm, nga rezerva dimërore. E njëjta gjë u krye edhe me fshatrat, jo vetëm me ata që ishin më afër qendrës, por edhe me më të largët. Ky "diktator" i udhëzonte të gjitha strukturat e shtetit që në çdo fshat e zonë, për situatë dimri, të dërgohej rezerva dimërore që pa filluar stina e dimrit. Në raste të rënda bllokimi, edhe repartet ushtarake ktheheshin në furnitorë të popullit me të gjithë artikujt e domosdoshëm jetësor. Ky ishte "diktatori" e shteti i "diktaturës"!

Ky dimri i sivjetshëm me sa duket ka "shpirtin" e kohës në të cilën jemi zhytur që nga viti kobzi i 1990-ës. Mjerimi, varfëria, papunësia, grindjet, mosmarrëveshjet, vrasjet e përçarjet, korrupsioni gjigand në shtet, vrasja e drejtësisë, mosndëshkimi i krimit, sikur e kane ulur në masën më të paimagjinueshme rezistencën popullore ndaj edhe fatkeqësisë më të vogël.

Fytyra e Shqipërisë së sotme është e zbehtë, e hequr, e vyshkur dhe e mbështjellë në vaje, shkaqet e të cilave pamje, kanë ardhur nga brengat e hallat e panumërta me të cilat është mbushur jeta e pjesës dërrmuese të popullit. Shqipëria e sotme vuan për kafshatën e thatë të bukës, vuan për lirinë e vërtetë, vuan për dritën e zhvillimit, vuan nga errësira e vëllavrasjeve dhe e gjakmarrjeve, vuan nga mungesa e një kujdesi njerëzor të një pushteti e të një shteti për shtetasit e vet, vuan nga pushtetarët që kujtohen për popullin vetëm kur u kërkojnë votat e, ngrënë mbi themelet e mjerimit popullor, këshillat e tyre te pasurimit marramendës, vetëm për ta, fëmijët e nip-stërnipërit e tyre biologjikë(!)

Shqiptarët, në të vërtetë kanë njëzet e dy vjet që po luftojnë për mbijetesë në dimrin e vërtetë të jetës së tyre, shkaktuar nga ardhja në pushtet e klasave të borgjezisë, e krimit dhe e kriminelëve të të gjitha llojeve që ngrënë e rrëzojnë strukturat e shtetit, në përshtatje me interesat e tyre antikombëtare. Kurrën e kurrës nuk është e

mundur që një pushtet e një shtet që nuk mbron e, as shpreh interesat e popullit, të bëhet, në asnjë rast e, në situatë si kjo e këtij dimri, jo se jo, mbrojtës e shprehës i interesave të popullit të lënë në mëshirë të fatit.

Shqipëria e sotme të ngjan me një valltare të sflitur që s'i ka mbetur gjë tjetër veçse të heq, në pragvdekjen e vet, "vallen" e vdekjes me vdekjen e saj.

Shqipëria e këtij dimri idhnak, po heq vallen me damën "demokraci", valle që ia mësoi ky sistem antivlerash e çnjerëzor, pa e ditur se të vallëzosh me vdekjen do të thotë të shkosh në mënyrë "artistike" drejt vdekjes. Përsëri Migjeni ynë i madh më vjen në ndihmë që ta mbyll këtë shkrim me plot nota trishtuese, për këtë Shqipëri të kallkanosur, në gjendje kome. Edhe unë them, i trishtuar, tek e shikoj Shqipërinë time kësh-tu, në këtë dimër idhnak e, në këtë përfshirje të saj nga "ortekët" e premtimeve, se po shpëtoi edhe këtë herë, "do të ndodhë mrekullia", si dhuratë, jo nga "Perëndia", por nga Qeveria, bash si për ata që u përmbytën nga bollëku i premtimeve, kur u përmbytën nga uji, në Shkodër e në Lezhë e, u "thanë" në "ngrohtësinë" e gënjeshtrove, lindur nga ato premtimet e bujshme, në ditët e vështira:

Bejreni këtë Shqipëri të ngrirë e, shtatoren e saj vendoseni diku në ndonjë shesh kryeqyteti të Evropës, në mënyrë që ajo "mike" e vjetër, ta shikojë çdo ditë veprën e vet "miqësore", ndaj kësaj toke hyjnore e, ndaj këtij Kombi më të lashtë se vetë kjo Evropë! E, në mos pastë diku ndonjë shesh, vendoseni në ndonjë sallë madhështore të BE-së e, përsëri, po s'pati as sallë të tillë, ia dhuronin ndonjë "miku" eurodeputet që ka "qarë" më shumë për ne në këto vite, e prapë, po s'pati të tillë që e meriton, ia falni djallit klasik që është ulur këmbëkryq tash njëzet e dy vjet në çdo qelizë të shtetit e pushtetit në këtë Shqipëri! Uroj që ky dimër të mos e ngrijë përfundimisht shpirtin jetësor, energjitë e brendshme dhe largpamësinë historike të shqiptarëve të vërtetë, për të dalë nga errësira e kthetrat e kriminalo-politikës, në dritën e Pranverës politike, në rrugën e ndritur nga vlerat kombëtare e, pikësëpari, nga drita e pashuar e Diellit të Galaktikës shqiptarë, ENVER HOXHA ynë i pavdekshëm!

